

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësve të institucioneve, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Gusht, 2023

Shqipëria çel punimet e konferencës së parë botërore “Shfrytëzimi i të dhënave për të përmirësuar matjen e korrupsionit”

31.08.2023 - 01.09.2023: Konferenca e parë botërore “Shfrytëzimi i të dhënave për të përmirësuar matjen e korrupsionit”, filloi punimet në Vjenë, me iniciativë të zyrës së UNODC pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të Akademisë Ndërkombëtare të Antikorrupsionit, IACA. Shqipëria u përfaqësua në konferencë me Zëvendësministren e Drejtësisë, Znj. Adea Pirdeni, e nderuar për të mbajtur fjalën e hapjes. Pjesëmarrja e Shqipërisë në konferencë dhe në sesionin e çeljes së saj, evidenton rolin dhe nismat e marra dhe promovimin e tyre në aktivitetet dhe arenën ndërkombëtare. Konferenca mbledhi bashkë drejtues politikë të vendeve të botës, ekspertë dhe profesionistë të fushës, akademikë dhe studiues, shoqëri civile e përfaqësues biznesi. Konferenca solli në vëmendje vigjilencën për luftën kundër korrupsionit e nevojën për ndërgjegjësim në përputhje me aktivitetet e UNODC dhe IACA, si dy organizma me ndikim në planifikimin dhe zbatimin e masave, në të gjitha vendet. UNODC e IACA kanë thelluar metodologjitë e matjes së korrupsionit në botë, duke mundësuar përdorimin e të dhënave që kanë dhe mund të përdorin vendet. Konferenca ishte një mundësi shumë e mirë diskutimesh dhe shkëmbimi eksperiencash, por edhe ndarjesh mendimesh mbështetur mbi të dhënat statistikore, matjen dhe vlerësimin e efektivitetit të organeve dhe autoriteteve antikorrupsion dhe mbi progreset e bëra. Përdorimi i teknologjisë dhe mjeteve të komunikimit morën një vëmendje të shtuar në diskutimet e paneleve të ndryshme.

Më shumë informacion gjeni në link: <https://grace.unodc.org/grace/en/news-and-events/unodc-iaca-global-conference-on-harnessing-data-to-improve-corruption-measurement.html>



Drafti final i raportit të monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, janar-qershor 2023



RAPORTI I MONITORIMIT PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023




04 - 16.08.2023: Drejtoria e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë ka përgatitur e draftit të dytë dhe final të raportit të monitorimit të planit të veprimit antikorrupsion, për periudhën janar-qershor 2023. Raporti është një pasqyrë e përpiktë e zhvillimeve të gjashtëmujorit të fundit, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023. Ky raport është vijim i punës së filluar me draftin e parë të monitorimit, përmendur në e-buletinin korrik 2023, i cili paraqet një analizë thelbësore të objektivave specifike të strategjisë, të shpërndarë në tre dimensionet e luftës kundër korrupsionit: *parandalim - ndëshkim - ndërgjegjësim*. Një vëmendje e veçantë në këtë raport i është kushtuar vlerësimit 6-mujor të treguesve të performancës dhe një vështrimi të thelluar të zbatimit të masave dhe aktiviteteve, nga i cili rezulton se: është instaluar regjistri elektronik për kërkesat dhe përgjigjet në 27 autoritete të reja publike; Agjencia e Prokurimit Publik ka nxjerrë 3 rekomandime mbi formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik; AKSHI regjistron 1227 shërbime elektronike për qytetarët; ILDKPKI ka përgatitur një raport vlerësimi për zbatueshmërinë e ligjit për sinjalizim in; Ministria e Financave dhe Ekonomisë evidenton 4030 rekomandime të pranura dhe zbatuara; Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka vijuar gjithashtu me zhvillimin e politikave të integritetit dhe transparencës në organet publike; AAPSK ka marrë në administrim pasuri të sekuestruar për veprën penale të korrupsionit në vlerën 32,034,000 lekë, ndërsa Policia e Shtetit ka shkëmbyer 443 praktika me partnerët ndërkombëtarë. Raporti vijon të mbetet i hapur për konsultim publik, me të gjithë partnerët e interesuar të luftës kundër korrupsionit. Gjatë muajit shtator 2023, përmbajtja e konsoliduar e këtij draft raporti, do të dakordësohet në nivel teknik me të gjitha pikat e kontaktit antikorrupsion në institucionet publike.

Gjeni raportin e monitorimit të publikuar në: <https://www.drejtësia.gov.al/raporte-monitorimi-2023/>

Ministria e Drejtësisë harton raportin e monitorimit janar - qershor 2023, të Planit të Integritetit

01.08.2023: Ministria e Drejtësisë, si institucioni lider në udhëheqjen e politikave të integritetit në vend, ka hartuar raportin e monitorimit janar-qershor 2023, në zbatim të Planit të saj të Integritetit 2020 - 2023. Ky raport monitorimi përshkruan hollësisht përmbajtjen dhe hapat e marrë nga ministria për zbatimin e masave të parashikuara nga Plani. Përmbajtja e raportit përshkruan 3 objektivat e Planit të Integritetit që përfshijnë procese të qarta të integritetit në Ministrinë e Drejtësisë, rëndësinë e burimeve njerëzore të kualifikuara për të parandaluar shkeljet e integritetit dhe përmirësimin e transparencës në punën e institucionit. Nga monitorimi i kryer rezulton se në totalin prej 12 masash, janë zbatuar plotësisht 11 masa, ndërsa 1 masë dhe 5 aktivitete mbeten ende në proces zbatimi. Raporti evidenton se janë ndërmarë hapa konkrete në drejtim të arritjes së këtyre objektivave, përfshirë ndërhyrjet aktive për të zbutur riskun e korrupsionit në të gjitha nivelet e ministrisë. Gjithashtu, nëpërmjet raportit, bëhet e ditur se ndërveprimi me aktorët e jashtëm të interesuar dhe publikun është një përbërës i rëndësishëm i përpjekjeve për të rritur transparencën dhe ndërtuar besimin. Ministria ka përbushur një sërë masash me sukses, ndërsa punon drejt përfundimit të objektivave të tjera në vijim. Raporti thekson gjithashtu se përpjekjet aktuale tregojnë një përmirësim të dukshëm në integritetin institucional, ndërsa hapat e mëtejshëm synojnë të ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit në vend. Me përfundimin e afatit të zbatimit të këtij plani në fund të vitit 2023, Ministria e Drejtësisë ka filluar gjithashtu punën për hartimin e një plani të ri që do të përgjigjet nevojave institucionale për vitet 2024-2027.

Më shumë informacion gjeni në link: <https://www.drejtësia.gov.al/instrumente-antikorrupsioni/>



Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion vijon me hetimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit

01-31.08.2023: Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë ka vazhduar me hetimet e thelluara administrative në disa institucione kyçe, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion. Vetëm gjatë muajit gusht 2023, në adresën zyrtare janë administruar 28 ankesa dhe denoncime nga burime të ndryshme. Pas një vëzhgimi të kujdesshëm administrativ, kanë përfunduar së hartuari 4 raporte përfundimtare. Ky proces është shoqëruar njëkohësisht edhe me ndërmarjen e 9 masave disiplinore ndaj individëve të identifikuar si të përfshirë në shkelje si dhe 7 rekomandime ndaj organeve publike. Gjatë kësaj periudhe, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit ka miratuar gjithashtu Planin e Kontrollit për 17 institucione pjesë të veprimtarisë së Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit, bazuar në dokumentin e Analizës dhe Vlerësimit të Riskut që është kryer për institucionet pjesë të Rrjetit. Si rezultat i këtyre veprimeve, Ministria e Drejtësisë ka qëndruar e angazhuar në garantimin e zbatimit të ligjit dhe përfundimin e praktikave të punës në institucioneve të prekura. Rrjeti i Koordinatorëve Kundër Korrupsionit ka vijuar thellimin e përpjekjeve me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin dhe intensifikimin të luftës kundër korrupsionit në të gjitha sferat e përfshira. Përdorimi i hetimeve administrative është një mekanizëm efektiv që ndihmon në forcimin e strukturave institucionale dhe rritjen e transparencës në sektorin publik. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion vazhdon të punojë me përkushtim për të krijuar një mjedis më të ndershëm dhe transparent në shërbim të qytetarëve dhe shtetit të së drejtës.

Në rast se hasni praktika korruptive në përballjen me insitucionet shtetërore, denoncojini ato në: koordinatoriak@drejtësia.gov.al

Udhërrëfyese Rajonal: Antikorrupsioni dhe prurjet financiare të paligjshme, bashkon nismat e rajonit në luftën kundër korrupsionit

17.08.2023: Udhërrëfyese Rajonal mbi Antikorrupsionin dhe prurjet financiare të paligjshme (the Roadmap), është në proces zbatimi. Ky dokument masash i ardhur si një propozim i Samitit të Berlinit në vitin 2018 për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe i hartuar e miratuar nga Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Mali i zi, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia, në qershor 2021, ka përfshirë struktura teknike dhe profesionistë të fushës së prokurimeve publike, deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe pronave, kontrollit dhe parandalimit të korrupsionit dhe organeve ligjzbatuese (polici-prokurori-agjenci të pastrimit të parave). Në muajin gusht 2023 u monitorua zbatimi i masave të përfshira në këtë plan-dokument dhe rezultoi se përgjatë kohës (2022-aktualisht 2023) për Shqipërinë janë realizuar me korrektësi procedurat e prokurimit publik, kapacitete të rritura të stafit të sektorit, deklarim online të pasurive të subjekteve deklarues, forcim të kapaciteteve parandaluese dhe struktura ndëshkimi eficiente, referuar SPAK dhe BKH. Zyra rajonale e UNODC për rajonin është duke monitoruar zbatimin e dokumentit në të gjitha vendet e rajonit dhe së shpejti do të ketë një takim për promovimin e progresit, respektiv. Monitorimi do ti shërbejë edhe identifikimit të nevojave për bashkëpunim mes vendeve, në vijim.

Më shumë informacion gjeni në link:

https://www.unodc.org/documents/southeasterneurope/AC_and_Illicit_Finance_Roadmap_Full_25.06_PDF.pdf



REGIONAL ANTI-CORRUPTION AND ILICIT FINANCE ROADMAP
RECEPTION REPORT FOR ALBANIA

